



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 47, datë 31.01.2024

PËR

**PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME
PËLQIM PËR GJYQTAREN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 94, datë 06.03.2023, “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...}”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtarja e transferuar me pëlqim, të jetë transferuar për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtaren znj. {...}.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.01.2024.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR